



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
INSTITUTI I ZHVILLIMIT TË ARSIMIT**

**PROGRAMI I KURRIKULËS ME ZGJEDHJE TË DETYRUAR PËR
SHKOLLAT E MESME TË GJUHËVE TË HUAJA**

FUSHA: GJUHË E HUAJ

LËNDA: GJERMANISHT

KODI: 3.3.11.Zgj.(av)

**PROGRAMI I LËNDËS
GJERMANISHT
PËR KLASËN E 11-të
NIVELI I AVANCUAR**

Koordinatori: Erifili Hashorva

Redaktori: Gazmend Krasniqi

Përgjegjës sektori: Marita Hamza

TIRANË, KORRIK 2010

Ky program do të ndihmojë në rregullimin, drejtimin dhe ndjekjen e të gjithë procesit mësimor të gjuhës gjermane pranë Shkollave të Mesme të Gjuhëve të Huaja, duke thelluar dhe avancuar më tej njohuritë e gjermanishtes për këtë grup nxënësish.

Programi i avancuar është hartuar duke pasur parasysh interesat e nxënësve të kësaj grupmoshe, të shprehura këto në tematikat e sferave të ndryshme, ai përshkohet nga objektivi kryesor: komunikimi në gjuhë të huaj në situata të ndryshme.

Theksohet se mësimi i gjermanishtes duhet t'i përgjigjet synimeve të arsimit në shkollat shqiptare, d.m.th. ai duhet të kontribuojë në aftësimin e nxënësve.

Njohuritë e përfuara në këtë program, si pjesë përbërëse e kurrikulës së re të arsimit të mesëm të lartë, mundësojnë rritjen dhe forcimin e njohurive të nxënësit jo vetëm në gjuhën gjermane, por edhe në lëndët e tjera, si, p.sh., në lëndët e historisë, të gjeografisë, të biologjisë etj., duke i ndërthurur këto dije në mënyrë logjike.

Kjo ndërthurje ndërëndore fiton një dimension të ri në përpjekjen për të siguruar dije të qëndrueshme dhe të vazhdueshme. Këto dije e përgatitin nxënësin, gjithashtu, për t'u përballur me studime të mëtejshme, si dhe me situata punësimi brenda dhe jashtë vendit.

1. SYNIMI I LËNDËS

Programi i avancuar i gjermanishtes për klasën e 11-të do të synojë një thellim dhe avancim të nivelit A2+(duke synuar B1 në aftësi të veçanta). Ky program synon:

- të thellojë dhe të avancojë pavarësinë dhe individualitetin intelektual, shoqëror dhe kulturor të, nxënësve të kësaj grupmoshe dhe do të nxisë krijimtarinë dhe mënyrën alternative të të menduarit;
- të rrisë dhe të avancojë aftësinë, veprim gjuhësor në situata autentike komunikative. Kjo do të mundësohet nëpërmjet një mësimi më të thelluar të orientuar për veprim;

2. OBJEKTIVA TË PËRGJITHSHËM

Programi i avancuar do të zhvillojë tek nxënësit thellim dhe avancimin në nivelin A2+: Në përfundim të kësaj klase nxënësi,-ja duhet te ketë:

- shkathtësi dhe saktësi në komunikimin me shkrim dhe me gojë;
- te jetë i aftë për të lidhur situatat gjuhësore të krijuara në klasë me ato të jetës reale;
- te jetë i aftë për të bërë dallimet ndërmjet kulturave të ndryshme;
- te punojë në grup dhe zotërojë shprehitë e një pune të pavarur individuale dhe krijuese.

3. OBJEKTIVAT

Objektivat e programit të avancuar për klasën 11-të do të zërthehen hollësisht sipas linjave e nënlinjave dhe aftësive gjuhësore si më poshtë:

a) Objektivat sipas standardit në komunikim

Përshkrimi: Objektivat e standardeve në këtë fushë krijojnë bazat e gjuhës, të cilat përbëjnë domosdoshmëri për një komunikim me një standard të lartë gjuhësor. Standardi në këtë fushë pasuron dijet e përgjithshme të nxënësit dhe e përgatit atë emocionalisht për një përballje reale me gjuhën dhe kulturën.

	Objektiva
Komunikimi	<p>Në fund të klasës 11-të nxënësi/nxënës-ja aftësohet:</p> <ul style="list-style-type: none"> • të komunikojë për detyra të thjeshta dhe rutinë që kërkojnë shkëmbim informacioni të drejtpërdrejt; • të përshkruajë me terma të thjeshta aspekte të formimit të tij; • të kuptojë informacionin kryesor dhe t’ia dalë në situata të caktuara të jetës së përditshme; • të shprehë pikëpamjet e tij; • të përshkruajë përvoja dhe ngjarje; • të përshkruajë përmbledhtas ëndrrat, dëshirat, ambiciet dhe planet për të ardhmen; • të përgatisë material të thjeshtë për tema të njohura; • të mbajë një qëndrim për tema të caktuara duke përdorur argumentin.
Aktet/funksionet e komunikimit	<p>Në fund të klasës 11-të nxënësi/nxënës-ja aftësohet:</p> <ul style="list-style-type: none"> • të tregojë një ngjarje, një përvojë, një ëndërr, të përshkruajë një shpresë; • të hartojë një biografi mësimore të thjeshtë në formën e një table; • të përshtatë gjuhën e mësuar më parë për kontekste të reja; • të përshkruajë përmbajtjen e një libri; • të përballojë shumicën e situatave duke rezervuar e p.sh një udhëtim ; • të informohet për të gjetur një rrugë dhe ndjek këshillat që i japin për këtë gjë; • të përliqje ose të sqarojë shkurt qëllimet , planet dhe veprimet e tij; • të transmetojë një informacion të thjeshtë me interes të domosdoshëm; • të flasë për fusha të ndryshme të interesit vetjak; • të flasë në mënyrë të zgjeruar për hobitë dhe interesat e tij.

b) Objektiva sipas standardit në kulturë

	Objektiva
Kulturë	<p>Në fund të klasës 11-të nxënësi/nxënës-ja aftësohet:</p> <ul style="list-style-type: none">• Të përcaktojë ndryshimet dhe të bëjë analogjitë me dy kulturat;• të shprehë kureshtjen për zakonet, traditat e kulturës së re;• të kuptojë sistemin shkollor gjerman dhe të përcaktojë të përbashkëta dhe të veçantat me sistemin e vendit të tij;• të njohë historinë dhe kulturën e gjuhës së re;• të njohë dhe të diskutojë mbi jetën dhe veprat e personaliteteve të ndryshme të fushave të ndryshme të kulturës, shkencës, modës, muzikës gjermane etj.

c) Objektivat sipas standardit në formimin gjuhësor

Përshkrimi: Objektivat e standardit në këtë fushë e aftësojnë nxënësin të prodhojë elemente gjuhësore që i përkasin thellimit të nivelit A2+. Në këto orë të mësimin të avancuar duhet të bëhet një punë më e thelluar dhe e avancuar për përvetësimin e saktë të njohurive të parat të gramatikës gjermane, kuptohet në funksion të komunikimit.

	Objektiva
Elemente gramatikore	<p>Në fund të klasës 11-të nxënësi/nxënës-ja aftësohet:</p> <ul style="list-style-type: none">• të përdorë të gjitha llojet e fjalive të nënrenditura;• të bëjë përmbledhjen e teksteve ;• të përdorë saktë strukturën Nebensatz vor dem Hauptsatz;• të përdorë saktësisht foljen në kohën e pakryer dhe të kryer të thjeshtë;• të përdorë Konjunktiv 2 der Hauptverben;• të bëjë përshkrimin e një libri apo të një filmi duke përdorur dhe lidhëzat dygjymtyrëshe;• të përdorë saktë lakimin e mbiemrave;• të tregojë duke përdorur kohën e kryer të tejshkuar;• të rendisë saktë rrethanorët dhe kundrinorët në fjali.

4. OBJEKTIVAT SIPAS AFTËSIVE GJUHËSORE

Aftësia	Objektiva
<p>Të dëgjuarit</p>	<p>Në fund të klasës 11-të nxënësi/nxënës-ja aftësohet:</p> <ul style="list-style-type: none"> • të kapë thelbin në mesazhe të shkurtra e të thjeshta si dhe në njoftime shkollore; • të kuptojë frazat dhe fjalët që lidhen me fushat e inversit të tij të çastit; • të ndjekë biseda të përditshme të artikuluar qartë që i drejtohen atij; • të kuptojë çështjet kryesore në buletin lajmesh.
<p>Të folurit</p>	<p>Në fund të klasës 11-të nxënësi/nxënës-ja aftësohet:</p> <ul style="list-style-type: none"> • të fillojë ,të vazhdojë,të përfundojë me bashkëfolësin një bisedë për një temë të njohur që i paraqet interes; • të shkëmbejë pikëpamje apo të shprehë mendime vetjake në një diskutim mes miqsh; • të sqarojë shkurt planet dhe qëllimet e tij; • të shprehë ndjenjë të tilla si: habia, gëzimi, trishtimi, kureshtja etj.; • të transmetojë një informacion të domosdoshëm duke theksuar pikën më të rëndësishme sipas mendimit të tij; • të zotërojë një fjalor të mjaftueshëm për tu shprehur, hera herës duke e perifrazuar për temat që i takojnë jetës së përditshme.

Të lexuarit	<p>Në fund të klasës 11-të nxënësi/nxënës-ja aftësohet:</p> <ul style="list-style-type: none"> • të lexojë artikuj ose intervista në gazeta e revista ku bëhet fjalë për tema dhe ngjarje aktuale duke kuptuar thelbin e informacionit; • të gjejë dhe të kuptojë informacionin apo faktet e kërkuara (p.sh kur dhe ku është kryer diçka) duke i hedhur një sy të shpejtë testeve të shkurtra; • të kuptojë mesazhe të thjeshta dhe letra standarde rreth udhëtimeve, shërbimeve postare, blerjeve etj; • të kuptojë subjektin e një tregimi të strukturuar mirë dhe të dallojë ngjarjet dhe episodet më të rëndësishme.
Të shkruarit	<p>Në fund të klasës 11-të nxënësi/nxënës-ja aftësohet:</p> <ul style="list-style-type: none"> • të shkruajë tekste të thjeshtë për tema të ndryshme, duke lidhur në seri elementet e rëndësishëm; • të përshkruajë një ngjarje, një udhëtim real apo imagjinar; • të shkruajë përmbajtjen e një libri për fëmijë, të një filmi etj; • të hartojë letra, kartolina, SMS dhe tekste të shkurtra me një gjuhë të kuptueshme dhe të qartë për veprimtaritë e përditshme.

5. KËRKESA TË GJUHËS GJERMANE NDAJ LËNDËVE TË TJERA

Programi i avancuar i gjuhës gjermane për klasën e 11-të mbështetet në integrimin ndërlëndor, duke e shfrytëzuar atë për aftësimin në rritje të nxënësve në përdorimin e njohurive gjuhësore, në përgjithësi dhe të katër aftësive (dëgjimit, leximit, të folurit e të shkruarit), në veçanti.

Konceptet dhe njohuritë e tjera gjuhësore trajtohen e mësohen më mirë në kontekste të caktuara kuptimore, që lidhen ngushtë me fusha tematike të parashtruara në programin e gjuhës gjermane e të trajtuara në lëndët e tjera.

Gjeografia, e cila me njohuritë e saj mund ti japë nxënësve informacione për vendet gjermanishtfolëse (Gjermani, Austri, Zvicër), vendet turistike, peizazhin, veprat e artit dhe t'i afrojë ato më tepër me kulturën e këtyre vendeve. Nxënësit do të mësonin për klimën, relievin, lumenjtë e këtyre vendeve.

Sociologjia, e cila do të ndihmonte nxënësit të njihnin dhe të kuptonin me mirë zakonet, kulturën, traditën e këtyre vendeve. Ato do të ndërgjegjësoheshin më shumë për diversitetin e kësaj bote dhe do të bëheshin më të ndërgjegjshëm, me tolerant duke kuptuar dhe thelbin e mentalitetit të këtyre vendeve.

Historia, e cila nëpërmjet informacioneve të saj mund ti afronte nxënësit më tepër me historinë gjermane. Ngjarjet e rëndësishme historike që shënuan fatin e shumë vendeve në botë dhe të vetë Gjermanisë do ti ndihmonin nxënësit të formonin mendimin e tyre për këto ngjarje duke kultivuar tek ato një mendim kritik.

Edukimin mjedisor: Ndotja dhe mbrojtja e mjedisit janë tema që shoqërohen me fjalor e struktura gjuhësore, të cilat trajtohen jo si një qëllim më vete, por në një kontekst kuptimplotë dhe edukativ.

Edukimin kulturor dhe etik: dy lëndët kryesore si gjeografia dhe historia do të ndikonin në formimin kulturor dhe etik të nxënësve nëpërmjet njohurive që trajtohen prej tyre. Zakonet, kultura dhe traditat e këtyre vendeve do të kultivonin tek nxënësit aftësinë për të kuptuar më mirë njerëzit, kulturën dhe mentalitetin e këtyre vendeve.

Edukimin për të drejtat e njeriut: Njohja e kulturave të vendeve gjermanishtfolëse realizohet e lidhur ngushtë me temat e barazisë sociale, të diskriminimit social, të respektit reciprok etj. duke i bërë nxënësit me tolerantë, të mirëkuptueshëm me njëri-tjetrin.

6. KËRKESA PËR ZBATIMIN E PROGRAMIT

Programi i avancuar gjuhës gjermane për klasën e njëmbëdhjetë është një dokument zyrtar, si pjesë e tërësisë së dokumenteve zyrtare për lëndën e gjuhës gjermane dhe duhet të zbatohet nga mësues, autorë të teksteve etj.

Siç është përmendur dhe më lart dokumentet e tjera kryesore janë:

- Kuadri i Përbashkët Evropian të Referencave për Gjuhët e Huaja.
- Kurrikula Kombëtare e Gjuhëve Moderne për Arsimin Publik Parauniversitar.
- Standardet e arritjes.

Programi i avancuar i klasës së 11-të orienton gjithë procesin e mësimdhënies e të nxënies së gjuhës gjermane në nivelin A2+.

A) Objektivat

Objektivat e këtij programi, me anë të të cilit nxënësit thellojnë njohuritë dhe avancojnë në mësimin e gjuhës gjermane, janë detyrim për përdoruesit e programit.

B) Orët mësimore

Në programin e thelluar në lëndën e gjuhës gjermane afërsisht **70%** e orëve mësimore totale janë për thellimin e njohurive të reja lëndore dhe **30%** e tyre janë për përpunimin e njohurive (gjatë vitit dhe në fund të vitit shkollor).

Shpërndarja e orëve mësimore në programin e thelluar të gjuhës gjermane

Ky program parashikon shtrirjen e mësimi të gjuhës gjermane në të gjithë vitin akademik dhe do të realizohet në 72 orë mësimore, me një frekuencë prej 2 orësh në javë, në 36 javë mësimore (**36 javë x 2 orë = 72 orë vjetore**).

Komunikimi dhe formimi kulturor zë 50 orë, të cilat ndahen, sipas objektivave që u përgjigjen, në 35 orë mësimore për kulturën dhe komunikimin (nga të cilat 70% e tyre, që përbëjnë 20 orë, do të jenë për trajtimin e lëndës së re, kurse 30% e tyre, që përbëjnë. Do të përdoren 15 orë, do të shërbejnë për përpunimin e njohurive; me përpunim do të kuptojmë, p.sh., përforsimin e informacionit të marrë në temat përkatëse ose ushtrime për mendimin kritik rreth këtij informacioni) dhe 15 orë për aktet dhe funksionet e komunikimit (nga të cilat 70% e tyre, që përbëjnë 11 orë mësimore, do të shërbejnë për njohuritë e reja, kurse 30% e tyre, d.m.th. 4 orë mësimore, do të përdoren për përpunimin e njohurive. Këtu mësuesi bën përpunim njohurish për integrimin tërësor të lëndës, d.m.th. ai jep detyra komplekse, ku pasqyrohen njohuritë e përfuara sipas aftësive dhe objektivave në një kapitull).

Orët e përgjithshme për përpunimin e lëndës janë 31 orë, nga të cilat 5% e tyre, d.m.th. 6 orë, do të përdoren për përpunimin e të gjithë lëndës, ku vlerësimi tërësor i lëndës zë vendin e tij (p.sh., 3 orë mund të përdoren për përsëritjen dhe 3 orë për vlerësimin me shkrim e me gojë të dijeve që kanë përfuar nxënësit gjatë procesit të nxënies).

Formimi gjuhësor zë 22 orë. Janë kryesisht orë në të cilat mësuesi shtjellon, në bashkëveprim me nxënësit njohuri gramatikore dhe ushtrime gjuhësore gramatikore e leksikore (nga të cilat 70% e tyre, që përbëjnë 14 orë mësimore, do të shërbejnë për trajtimin e strukturave të reja, kurse 30% e tyre, që përbëjnë 8 orë, do të shërbejnë për rimarrjen, përpunimin dhe përforsimin e tyre).

Përpunimi i njohurive në programin e avancuar përmban:

- Përsëritjen e njohurive thellim dhe avancim i tyre.
- Testimin e njohurive të avancuara.
- Integrimin e njohurive të thelluara të lëndës me njohuritë e marra.
- Integrimin e aftësive të reja me njohuritë e lëndëve të tjera (Ndonëse këto integritime do të përshkojnë zhvillimin e çdo ore mësimore, gjatë përpunimit i duhet kushtuar kohë e posaçme).
- Përsëritjen vjetore.
- Testimin vjetor (nuk është i detyruar).

Gjatë përpunimit të njohurive të thelluara, duhet ti kushtohet kohë e posaçme kultivimit:

- Të aftësive të përgjithshme si të komunikimit, menaxhimit të informacionit, zgjidhjeve problemore, të menduarit kritik dhe krijues.
- Të aftësive të posaçme lëndore si komunikimi gojor, shkrimi riprodhues e krijues, kuptimi i teksteve me vështirësi dhe gjatësi mesatare, kalimi nga kuptimi thelbësor te ai më i detajuar, kuptimi me gojë dhe ndërveprimi bisedor, etj..
- Të formimit të qëndrimeve, si qëndrimi etiko-social .

Strategjitë e të nxënit

Aftësia	Strategjitë
Të dëgjuarit	<p>Në fund të klasës 11-të nxënësi/nxënës-ja ushtrohet:</p> <ul style="list-style-type: none"> • të kuptojë përmbajtjen dhe rendin e ngjarjeve në një tekst; • të kuptojë dhe të gjejë informacione të sakta në një tekst të shkurtër dëgjimi; • të kuptojë informacionet, udhëzimet te cilat i shërbejnë si impulse në situata të caktuara të jetës së përditshme; • të kuptojë informacionin në detaje në njoftime të shkurtra; • të shkëmbejë informacione në situata të parashikuara të jetës se përditshme.
Të folurit	<p>Në fund të klasës 11-të nxënësi/nxënës-ja ushtrohet:</p> <ul style="list-style-type: none"> • të marrë dhe të japë informacione për ngjarje të së tashmes, të shkuarës dhe të ardhmes; • të shkëmbejë informacione dhe ide në lidhje me tema te interesit vetjak në situata bashkëbisedimi të pakomplikuara.
Të lexuarit	<p>Në fund të klasës 11-të nxënësi/nxënës-ja ushtrohet</p> <ul style="list-style-type: none"> • të lexojë dhe të kuptojë njoftimet kryesore të tabelave dhe parullave publike; • të kuptojë tekste të shkurtra që përmbajnë dhe internacionalizma; • të kuptojë tekste të gjata për tema të njohura të pasura me foto.

Të shkruarit	<p>Në fund të klasës 11-të nxënësi/nxënës-ja ushtrohet:</p> <ul style="list-style-type: none"> • të hartojë tekste të shkurtra dhe të thjeshta në lidhje me një kontekst të caktuar të aspekteve të jetës së përditshme; si mjedisi; • të shkruajë tekste të thjeshta me mendimet dhe argumentet personale; • të kontrollojë lidhjen logjike të paragrafëve duke përdorur lidhëzat dygjymtyrëshe dhe lidhëzat e nënrenditura; • të reagojë ndaj teksteve duke dhënë mendimin e tij personal në lidhje me përmbajtjen dhe tematikën.
---------------------	---

Parime për zbatimin e programit

Më poshtë disa parime për zbatimin e programit :

Vendosja e nxënës/it,-es në qendër të vëmendjes

Nxënësi duhet të jetë në qendër të procesit mësimor dhe të gëzojë të drejta të plota pjesëmarrjeje duke shprehur përvojën e tij jetësore. Kjo do të realizohet:

- Duke përzgjedhur tema, lloje të teksteve dhe forma sociale të orientuara sipas interesave dhe nevojave të moshës së klasës së njëmbëdhjetë, duke patur parasysh nivelin dhe rezultatet e tyre, duke pasur parasysh qëllimin e këtyre orëve: thellim dhe avancim.
- Duke përdorur strategji që e nxisin nxënës/in,-en të veprojnë me gjuhën.
- Duke e përfshirë nxënësin në vlerësimin dhe vetëvlerësimin e dijeve të përfutuara.

Organizimi i mjedisit të së nxënës

Duke krijuar një mjedis shkollor motivues, te qetë dhe jo frenues nxënësi ka dëshirë të jetë më aktiv gjatë procesit mësimor dhe kjo është detyrë e mësuesit, të cilët ,duhet të ndërgjegjësohen për rolin e tyre në këtë drejtim. Është detyrë e mësuesit të ideojë dhe krijojë mjedise që nxisin dëshirën dhe vullnetin e nxënësve gjatë procesit mësimor.

Organizimi i klasës

Duke dalë nga forma standarde tashmë e vjetruar e mësimdhënies frontale dhe duke e vënë nxënësin në qendër të vëmendjes mësuesi do të bëhet organizues, furnizues dhe orientues për nxënësit duke i bërë ata pjesë aktive dhe jo pasive në mësim. Ai do t'i ndihmojë nxënësit për një të mësuar të qëndrueshëm. Mësuesi ka më tepër rol planifikues sesa burim i të gjitha njohurive në klasë.

Mësimdhënia ka në qendër të saj metodën komunikative, metoda me bazë detyrën, metoda funksionale dhe ajo e situatave sa më afër jetës reale etj. Mësuesi është i lirë dhe i pavarur në përdorimin e metodave dhe materialeve mësimore që mbështesin krijimtarinë dhe pavarësinë mendore si të nxënësve , ashtu edhe të mësuesve

Puna në grupe, me partner motivon nxënësit të cilët mësojnë më tepër nga shkëmbimi i informacionit me njeri tjetrin. Mësuesi ideon orën e mësimit dhe nxënësit bëhen aktiv nëpërmjet formave bashkëvepruese të mësimdhënies të cilat zgjidhen nga mësuesi. Edhe këtu duhet të punohet që nxënësi/i,-ja të punojë në mënyrë të pavarur, duke menduar vetë për zgjidhjen e një problemi të përcaktuar më parë.

Të mësuarit bashkëveprues

Format e reja të punës p.sh. në grupe, me partner i bën nxënësit me bashkëveprues, me tolerant duke i aftësuar të përdorin forma demokratike në bashkëbisedim duke ndarë përgjegjësitë dhe punën. Nxënësit mësojnë të shoqërohen dhe të punojnë me të tjerë.

Nxënësit aftësohen drejt pavarësisë në rritje në përfitimin gjuhësor gjatë mësimit të gjermanishtes, e mundësuar kjo nëpërmjet aktiviteteve përkatëse të mësuarit, formave të larmishme sociale.

Të mësuarit e gramatikës

Gjuha gjermane ka si element të rëndësishëm dhe strukturat gramatikore të cilat nuk duhet të jepen të izoluara, si qëllim në vetvete, por në lidhje me aftësitë gjuhësore dhe me përpunimin e temave dhe kompetencave leksikore.

Gramatika duhet të konceptohet përgjithësisht në mënyrë deduktive me qëllim që të nxiten nxënësit drejt një procesi analitik dhe nga mendimi kritik. Kjo do të thotë që nxënësi duhet të dalë vetë nëpërmjet shembujve të shumtë dhe të larmishëm tek rregullit gramatikor. Duhet të hiqet dorë nga dhënia e rregullave dhe tabelave shabllone, paraprake nga mësuesit.

Duke pasur parasysh synimet e orëve të avancimit, puna me gramatikën duhet të synojë thellimin dhe avancimin e këtyre njohurive, konkretisht të nivelit A2+; synim të nivelit B1 në aftësi të veçanta.

Puna e diferencuar

Thellimi dhe avancimi i njohurive të gjermanishtes bazohet në punën e diferencuar, ku do të përfshihen nxënës që kërkojnë avancim në këtë gjuhë. Duke pasur parasysh përbërjen heterogjene të klasave tona mësuesi duhet të parapëlqejë punën në grupe, kështu ai mund të krijojë grupe mikse me nxënës/e të përparuar dhe të prapambetur; duke caktuar detyra në grup për të mos i vënë në vështirësi këta nxënës dhe për t'i inkurajuar të zgjidhin ato detyra që munden. Mësuesi mund t'u japë gradualisht detyra plus për të siguruar një nivelim të tyre me të tjerët, por duke bërë kujdes që të mos rrisë vështirësitë e tyre dhe duke gjetur detyra motivuese e tërheqëse.

Një motivim i mirë për thellimin e njohurive të gjermanishtes, konkretisht për nxënësit e përparuar është puna e veprimtarive shpesh, si përzgjedhje e materialeve autentike, krijime me shkrim në kuadër konkurrimesh, recitime ose vënie në skenë të pjesëve të ndryshme në gjuhë të huaj, etj. Ai mund të përdorë punën e këtyre nxënësve

për të realizuar bashkë me ta një aspekt shumë të rëndësishëm të metodologjisë së zbatimit të programit si integrimi lëndor, ku nxënësit e përparuar mund të sjellin një kontribut të konsiderueshëm nëpërmjet transferimit të njohurive të tyre nga gjuha dhe kultura amtare në gjuhën dhe kulturën e huaj dhe anasjelltas.

7. VLERËSIMI

Matja e përparimit dhe arritjeve të nxënësve në gjuhën e huaj, duhet të jetë objektiv i rëndësishëm në punën e mësuesit.

Të vlerësosh nxënësin nuk është e lehtë dhe kjo mund të bëhet në mënyra nga më të ndryshme.

Vlerësim diagnostikues

Duke njohur dhe vlerësuar arritjet dhe mangësitë, duke i dëgjuar nxënësit të flasin dhe lexojnë, duke vëzhguar të shkruarit e tyre dhe duke analizuar aftësitë dhe gabimet e nxënësve përmes përdorimit të analizës së rezultateve dhe evidencave të rregullta mësuesi do të mund të realizojë këtë vlerësim:

- ky lloj vlerësimi jep informacion për efektshmërinë e të nxënësit,
- ndihmon në gjetjen e mënyrës së veprimit në etapën e dytë të të mësuarit,
- ndihmon të gjenden arsyet dhe shkaqet e mospërvetësimit të koncepteve.

Vlerësim formues

Nëpërmjet këtij vlerësimi synohet të theksohet ajo çfarë ka arritur nxënësi gjatë procesit të formimit të njohurive. Ky vlerësim kryhet në fillim: për vendosjen e objektivave në procesin mësimor, gjatë vitit: për të vlerësuar ecurinë njohurive të fituara, për përmirësim si dhe në fund të vitit për të parë se çfarë është arritur.

Më poshtë sugjerohen disa i-veprimtari ose kërkesa për vetë-vlerësimin formues;

- pas një veprimtarie të bëhet një pushim dhe të bëhet pyetja “Çfarë keni mësuar?”;
- t’i bëhet e ditur nxënësit që gjithnjë duhet të bëjë një bilanc të gjërave të mësuara dhe atyre të përvetësuara;
- në një situatë me rezultat të lartë të pyeten nxënësit “Çfarë bëtë për të arritur këtë rezultat?” dhe të nxiten ata të shkëmbejnë përvojën e tyre mbi këtë temë;
- pas një krijimi me shkrim, t’i kërkohet nxënësit të tregojë çdo gjë për të cilën është i sigurt në tekstin e tij (duke nënvizuar, për shembull).

Vlerësim përmbledhës

Ky vlerësim bëhet në fund të një numri temash , njësisish, detyrash e kapitujsh , ose në fund të një periudhe të caktuar kohore.

Vlerësim motivues: ka për qëllim të nxis interesin dhe dëshirën e nxënësve për të mësuar.

Vlerësimi i nxënës/it,-es përshkon gjithë procesin mësimor dhe shërben për përmirësimin e këtij procesi. Vlerësimi i nxënës/it,-es nuk ka për qëllim të vetëm vendosjen e notës dhe as nuk përfundon me vendosjen e saj

Vlerësimi i nxënës/it,-es duhet të jetë sa më objektiv dhe i matshëm.

Do të inkurajohen nxënësit të njohin procedurat e vlerësimit si mundësi për *vetëvlerësim*. Nxënësit do të nxiten të zhvillojnë të menduarit e pavarur dhe vetëdijen për aftësinë e tyre për përmirësime përmes kuptimit të hollësishëm të proceseve të vlerësimit. Nëpërmjet vlerësimit vetëvlerësues nxënësit vlerësojnë veten nëpërmjet një pyetësi mbi atë ‘se çfarë di të bëjë’.

Vetëvlerësimi është një formë e re por mjaft e përhapur tashmë në botën arsimore. Ai është pjesë e të mësuarit të pavarur dhe konsiderohet mjaft i nevojshëm si nga nxënësit ashtu dhe nga mësuesit. Është detyrë e çdo mësuesi të shpjegojë dhe të njohë nxënësit me përmbajtje e vetëvlerësimit, përdorimi i të cilës do të sjellë ndërgjegjësime të mëtejshme të problemeve të të mësuarit.

Si mjet në vlerësim dhe vetëvlerësim shërben Portofoli Evropian Gjuhëve (PEGJ), që me anë të tri pjesëve të tij Pasaportës Gjuhësore, Bibliografisë gjuhësore dhe Dosjes, nxisin nxënësin të mendojë mbi nivelin e tij gjuhësor, duke vetëvlerësuar njohuritë e marra, dhe dokumentimin e arritjeve të tij gjuhësore që mund të jenë provime me shkrim, detyra tematike, certifikata, projekte kurrikulare, fotografi e produkte të veprimtarive aurikulare.

PEGJ është dokumenti në të cilin çdo nxënës që mëson ose ka mësuar një gjuhë që mësohet në shkollë ose jashtë saj, mund të shënojë njohuritë e tij gjuhësore dhe përvojat kulturore. PEGJ e nxit nxënësin të mësojë më shumë gjuhë, edhe në nivele modeste dhe të vazhdojë t’i mësojë gjuhët përgjatë gjithë jetës. PEGJ e nxit nxënësin të përmirësojë mësimin dhe aftësinë e vlerësimit të aftësive të tij në fushën e gjuhëve. PEGJ kontribuon në mirëkuptimin reciprok në Evropë nëpërmjet njohjes së drejtpërdrejtë të kulturave të tjera dhe ndihmës së kapaciteteve të komunikimit në shumë gjuhë.

- Nxënësit vlerësojnë punën e tyre në çifte. Më pas mësuesi dhe nxënësit bëjnë komentimin përfundimtar.
- Nxënësit vlerësojnë punën e njëri-tjetrit në grupe, duke marrë role të ndryshme, madje dhe pa nevojën e ndihmës së mësuesit.
- Mësuesi bisedon me nxënësin individualisht dhe i tregon arritjet.

Interesi më i madh i vetëvlerësimit qëndron në faktin që ai është faktor motivimi dhe ndërgjegjësimi: ai i ndihmon nxënësit të njohin pikat e tyre të forta dhe të dobëta dhe kështu të organizojnë më mirë të nxënit e tyre. Nga vetëvlerësimi përfiton si nxënësi, ashtu edhe mësuesi.

Gjithashtu mund t’i kërkohet nxënësit të hartojë një skedë vetë-korrigjimi, për të korrigjuar me shkrim gabimet më të shpeshta ose ta integrojë korrigjimin në veprimtarinë e kërkuar.

Në veprimtarinë e mëposhtme, do të përpiqemi të paraqesim përftyrimet që ka nxënësi/ja për suksesin e një veprimtarie të dhënë.

“Mendoni se keni pasur sukses?”

Objektivat

- Ta mësojmë nxënës/in,-en të vendosë veten në lidhje me kushtet e duhura të suksesit.
- Ta mësojmë t’i shohë krijimet e tij me sy kritik.
- Të nxjerrim në pah disa përfytyrime që ka nxënës/i,-ja për punën e tij vetjake dhe për atë që ai e quan sukses.

Ecuria

- Pas një veprimtarie krijimi ose vlerësimi, pyesim çdo nxënës/e se ç’notë ose ç’vlerësim ai (ose ajo) mendon të marrë dhe pse. Kjo pjesë e dytë e pyetjes zbulon përfytyrimet që ka nxënës/i,-ja për rezultatin e arritur dhe për raportin ndërmjet punës së tij dhe krijimit të pritur.
- Kur bëhet korigjimi, është shumë e dobishme për nxënës/in,-en të krahasojë vlerësimin e marrë dhe vlerësimin e pritur.
- Ç’notë mendoni të merrni dhe pse?

Bashkëbisedimi i lirshëm dhe i hapur me mësuesin është elementi më i rëndësishëm dhe nuk është detyrim për mësuesin vënia e notave çdo ore mësimore. Ai duhet të vejë herë pas herë nota, por këto nuk duhet të jenë objektivi i vetëm i punës gjatë orës së tij mësimore.

Vlerësimi me shkrim shërben për aftësimin në komunikimin me shkrim dhe mund të realizohet jo vetëm me laps e letër, por edhe në rrugë elektronike.

Mësuesi vlerëson nxënësin me notë për parashtrimet me shkrim në provimet periodike me shkrim dhe në prezantimet me shkrim të punimeve të tij, të realizuara vetë ose në grup.

Mësuesi planifikon *provime periodike* me shkrim për blloqe të gjera orësh mësimore, që përbëhen nga një a disa kapituj, të cilët i bashkojnë objektiva të ndërlidhur të të nxënësit. Në përshtatje me qëllimin e vlerësimit me shkrim, ai përdor lloje të ndryshme testesh, që nga minitestet pakminutëshe për një objektivi të veçantë të të nxënësit, deri tek ato njëorëshe; teste me alternativë ose zhvillim, detyra tematike, projekte kurrikulare etj.

Një formë e punës me shkrim nga nxënësit është dhe provimi përfundimtar. Portofoli i nxënësit, si një mundësi vlerësimi e vetëvlerësimi, është një koleksion i punimeve të tij përgjatë vitit shkollor për një lëndë të caktuar. Ai mund të përmbajë provime me shkrim, detyra tematike, projekte kurrikulare, fotografi e produkte të veprimtarive kurrikulare. Përzgjedhjet për portofolin bëhen nga nxënësit, kurse mësuesi është në rolin e atij që drejton, që rekomandon.